

Tiranë, më 21.12.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Internet –Intranet”, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat për 2 vite”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të interkoneksionit

VLERA E FONDIT LIMIT: 60,000,000 (gjashtëdhjetë milion) lekë pa TVSH

Në Euro - 524,705 (pesëqind e njezet e katër mijë e shtatëqind e pesë) euro, pa TVSH.

Sipas kursit zyrtar të këmbimit (Banka e Shqipërisë) 1 (një) EURO këmbëhet me 114.35 Lekë, datë 21.12.2022.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SHA Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;

b. Lista e çmimeve të Shërbimeve ,sipas Shtojces 2;

c. Sigurimin e Ofertës, në vlerën 1.200.000 (nje milion e dyqind mijë) Lekë, ose 10,494 (dhjetë mijë e katerqind e nëntëdhjetë e katër) Euro, sipas Shtojcës 3;

ç. Formulari i Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 4;

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 99% e vlerës së fondit limit** të kontratës që prokurohet. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 99% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 39 % të vlerës limit gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetary, vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik për sigurimin e cilësisë së shërbimit dhe sigurinë e manaxhimit të të dhënave në rrjet duhet:

- a) Të jetë i pajisur me *Çertifikatë ISO 9001:2015*, ose ekuivalente, në fushën e instalimit dhe shërbimeve të rrjeteve kombëtare të Komunikimit. *(sipas objektit të prokurimit)*
- b) Të jetë i pajisur me *Çertifikatë ISO 27001:2013*, ose ekuivalente, për sigurinë e menaxhimit të të dhënave në rrjet. *(sipas objektit të prokurimit)*
- c) Të jetë i pajisur me *Çertifikatë ISO 20000-1:2011*, ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve në teknologjinë e informacionit. *(sipas objektit të prokurimit)*

(Certifikatat duhet të jete të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqiperise)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Certifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rendësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshem e i kodifikuar). Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet nderkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Kjo vjen pasi në këte kontratë do ketë edhe furnizime të reja ashtu si edhe migrim të dhenash/mirembajtje e upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këte drejtim.

Certifikimi **ISO 20001-1:2011** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në tërësi i cili është tërësisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky lloj certifikimi garanton gjithashtu Autoritetin Kontraktor se shërbimet e ofruara gjatë zbatimit të kontratës janë sipas standarteve ndërkombëtare për menaxhimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për stafin e punonjësve të operatorit ekonomik, si dhe listëpagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 25 (njetzet e pese) punonjës për 3 mujorin e fundit, nga të cilët:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

a) 5 (pesë) Inxhinierë Informatikë/Telekomunikacioni/Elektronik, vërtetuar me kontratat e punës shoqëruar me diplomat përkatëse.

(Nisur nga objekti i prokurimit, volumi dhe kompleksiteti i shërbimeve të kerkuara dhe numri i zyrave/filialeve të percaktuara në Specifikimet teknike, kërkesa prej 10 Inxhinierë Informatikë/Telekomunikacioni/Elektronik, janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës.)

b) 2 (dy) persona të certifikuar për rrjetat e të dhenave në nivel Associate (CCNA) ose ekuivalente.

(U gjykua e arsyeshme nga njësia e prokurimit të kërkohej 2 persona të certifikuar në nivel Associate (CCNA ose ekuivalent) për arsye se certifikimi CCNA ose certifikata ekuivalente të saj, siguron Autoritetin Kontraktor për profesionalizimin e stafit të angazhuar në projekt, të cilët të pajisur me këto lloje certifikatash zotërojnë aftësi dhe dije në instalim, konfigurim dhe operim në LAN, WAN dhe shërbime networku).

Për punonjësit e stafit teknik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmitë dhe certifikatat përkatëse.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e plotë të zgjidhjes teknike për ofrimin e shërbimeve të kërkuara të linjës primare dhe back-up, të shoqëruar me përshkrimin dhe skemat e rrjetit të ofruesit të shërbimit për çdo pikë. Nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, kjo duhet të jetë e provueshme në 10 (dhjetë) zyra postare të përzgjedhura nga AK, brenda 7 (shtatë) ditësh kalendarike.

Argumentimi:

(Kriteri i vendosur garanton autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë për autoritetin kontraktor besim, siguri dhe garanci për cilësinë e shërbimit objekt prokurimi, shërbimi i Intranet/Internet në Zyrat Postare në Filale e Degë të Posta Shqiptare SHA sic kërkohet në Shtojcën 5 - Specifikimet teknike. Gjithashtu, afati prej 7 ditëve kalendarike brenda të cilit duhet të provohet ky kriter, në rast nevojë të AK, diktohet nga vendimi nr. 928, datë 26.09.2022 dhe vendimi nr. 1135, datë 22.11.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik. Sipas Njesisë së Prokurimit afati 7 (shtatë) ditor për të provuar përmbushjen e këtij kriteri në 10 (dhjetë) zyra postare, vlerësohet i mjaftueshëm dhe proporcional me afatin 45 ditor për implementimin e zgjidhjes teknike në 424 zyra postare të listuara në Shtojcën e Specifikimeve Teknike.)

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të zotërojë një infrastrukturë të vetën për shtrirjen e rrjetit me mbulim në të gjitha qytetet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, që verteton kapacitetin e Operatorit Ekonomik për realizimin e shërbimit, ose në rast se operatori nuk disponon një infrastrukturë të vetën shtrirje rrjeti, të kërkuara në këto specifikime, atëherë operatori duhet të paraqesë në procedurë prokurimi një kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP-i.

Kjo kontratë e qirasë/marrëveshje bashkëpunimi, në rastin e marrjes së këtij shërbimi, duhet të dokumentohet për ofrimin e shërbimit me mbulim në të gjithë qytetet.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim/Çertifikatë/Autorizim nga AKEP-i, se operatori ka shtrirje rrjeti kombetare ne mbare Shqiperine sipas vendodhjeve te pikave postare te autoritetit kontraktor.
- në rastin e kontratës me qira/marrëveshje bashkëpunimi, operatori ekonomik paraqet Vërtetim/Çertifikatë/Autorizim nga AKEP-i, në emër të operatorit qiradhënës/bashkëpunues, e cila mbulon afatin e kontratës për ofrimin e aksesit të internetit sipas pikave ku ka vendndodhjen autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Fibrat optike janë forma më e shpejtë e internetit (bazuar dhe në specifikimet teknike ku shpejtësia e transmetimit është 1Gb/s) dhe transferimit të të dhënave aktualisht në dispozicion dhe duke qënë në kushtet që shërbimi i internetit kërkohet të jetë lidhje me fibër optike, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se zotëron një infrastrukturë të vetën me fibër optike që të përmbushë nevojat e Autoritetit Kontraktor në vendndodhjen e tij. Në kushtet kur Operatori Ekonomik nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike pranë vendodhjes së Autoritetit Kontraktor, apo filialeve dhe degëve të Autoritetit Kontraktor, pranon paraqitjen e një kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP-i duke përmbushur kushtet e Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

*Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas **Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.***”*

*Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 të ndryshuar me VKM-në Nr. 710, date 24.11.2021, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.***

Operatori i huaj ekonomik duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e mësipërme duke paraqitur dokumentat përkatëse lëshuar nga institucionet përgjegjëse në shtetin e tyre konform ligjeve

në fuqi. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

-Vlera Limit E Kontratës

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 “**Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- 1. çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- 2. studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- 3. çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë, objektin të procedurës së prokurimit, duke përlogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve të reja (përfshirë virtualizimin) dhe shërbimeve të migrimit, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në çdo rast ku ka qenë e mundur është përdorur termi “ose ekuivalent” për të qenë gjithmonë në konformitet me zbatimin e legjislacionit të prokurimeve publike dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tyre.

III. Argumentimi ne lidhje me Nenin 39 te LPP Ndarjen e Kontratave ne Lote

Shoqeria “Posta Shqiptare” Sha, në aktivitetin e saj të përditshëm e bazon punën në operacionet financiare dhe postare dhe që përbëjnë burimet kryesore të të ardhurave të saj.

Shërbimi Intranet është shërbimi që mundëson komunikimin e zyrave postare, filialeve dhe degëve me sistemin qendror të Posta Shqiptare sh.a., kurse shërbimi Internet mundëson komunikimin e burimeve informatike të shoqërisë me botën e jashtme, si dhe anasjelltas.

Bazuar në domosdoshmërinë e informatizimit të zyrave postare, filialeve dhe degëve me rrjetin qendror të shoqërisë dhe programit ekonomik të shoqërisë, drejtorja e IT & Zhvillimit sheh të arsyeshme fillimin e procedurave për prokurimin “Blerje Internet- Intranet Marrëveshje kuadër për 2 vite”.

Qëllimi i këtij prokurimi është informatizimi i zyrave postare, filialeve dhe degëve dhe lidhja online e tyre me rrjetin qendror të Posta Shqiptare sh.a. për ofrimin e shërbimeve në kohë reale në çdo skaj të Shqipërisë për klientet e shoqërisë.

Në zbatim të Paragrafit 2 Pika 1 e Nenit 39 të LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka për zgjedhur ndarjen në Lote të procedurës së prokurimit për arsye se kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në kontrata të ndryshme sepse nga vetë objekti i prokurimit kemi të bëjmë me një sistem unik Internet- Intranet i cili bazohet në produkte të reja dhe karakterizohet nga ndër lidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike prodhuesish të ndryshem botëror.

NJËSIA E PROKURIMIT